



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna / Municipality
Hani i Elezit



Nr: 12/3403/2026
Datë: 14.04.2026

Në mbështetje të nenit 22 të Rregullores Nr.01/8214/2024 të dates 04.10.2024 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve si dhe Rregullores MF me Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve Komuna e Hanit të Elezit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për aplikimin e subvencionimit të OJQ-ve në fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe OJQ-ve tjera në vlerë totale prej 43,000.00 €

KULTURË (subvencione në vlerë totale prej 8,000.00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha shoqëritë kulturore- artistike (jo fitimprurëse) të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit - Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit të cilat janë të dëshmuara për organizimin e aktiviteteve kulturore por gjithnjë duke u bazuar në planprogramin e tyre vjetor për vitin 2026 të sektorit për Kulturë.

RINI DHE SPORT (subvencione në vlerë totale prej 33,000.00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha klubet sportive të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit- Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të cilat janë të dëshmuara për promovimin zhvillimin dhe masovizimin e sportit por gjithnjë duke u bazuar në planprogramin e garave të tyre për vitin 2026 të sektorit për Sport.

OJQ -TË TJERA (subvencione në vlerë totale prej 2,000.00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit- Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të cilat me projektet e tyre duhet të kenë objektiv zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht kujdesit, evokimit dhe këshillimit të personave dhe kategorive të ndryshme.

Kërkesa për aplikim për të gjithë sektorët Kulturë Rini dhe Sport dhe OJQ-të tjera duhet të përmbajnë:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Propozimin bashkë me koston totale;
- Aplikacioni (merret te Qendra për shërbim të qytetarëve);
- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Cerifikata e vendbanimit (për persona fizik);
- Cerifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Kalendarin e garave të vitit paraprak
- Vërtetimi i regjistrimit pranë federateve përkatëse(vetëm për klubet);
- Letërnjoftimi i personave /aplikantit/es që përfaqëson organizatën;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare e aplikuesit/es;
- Dëshmi që kanë realizuar aktivitetet brenda Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2025;
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- Raporti narrativ i vitit 2025 ose periudhës së mëhershme kur aplikuesi/ja ka qenë përfitues i subvencionimit;
- Gjatë aplikimit të subvencionimit 2026 aplikuesi/ja OJQ-të janë të obliguar të dorëzojnë faturat origjinale të shpenzimeve;

Afati për aplikim është nga data 14.04.2026 deri 30.04.2026

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Hani të Elezit Qendra për Shërbim të Qytetarëve.

Vërejtje:

- Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohen;
- Konkuresit/et të cilët nuk kanë përmbyllur avancet e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;
- Aplikacionet që dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen;
- Preferohet të gjitha dokumentet të plotësohen në mënyrë elektronike.

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

